



Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2217 Nr. i fag/Br.str/No.pg. 385
Data/Datum/Date 2 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: MAJ 2022

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për caktimin e komisionit	NRP-2028-02-2022
2.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontrates	NRP-2029-02-2022
3.	Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e sportit nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	NRP-2036-02-2022
4.	Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e kulturës dhe rinisë	NRP-2037-02-2022
5.	Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë	NRP-2075-02-2022
6.	Vendim për lirimin nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil	NRP-2076-02-2022
7.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmit	NRP-2078-02-2022
8.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2082-02-2022
9.	Vendim për derivate	NRP-2084-02-2022
10.	Vendim për lejimin e udhëtimit zyrtar	NRP-2085-02-2022
11.	Vendim për caktimin e komisionit të Nën-granteve	NRP-2091-02-2022
12.	Vendim për punë praktike	NRP-2092-02-2022
13.	Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë	NRP-2106-02-2022
14.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontrates dhe mbikëqyrësit të drejtperdrejtë të menaxherit të kontrates	NRP-2111-02-2022
15.	Vendim për formimin e komisionit për regjistrimin e sendeve të lujtshme nga objekti i banimit që gjendet në Zonen kadastrale Krushë e Madhe	NRP-2112-02-2022
16.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2113-02-2022
17.	Vendim për caktim e zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike	NRP-2117-02-2022
18.	Vendim për caktimin e zyrtares përgjegjëse për menaxhimin e Platformes së konsultimeve publike	NRP-2118-02-2022
19.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-2121-02-2022
20.	Vendim për trajnimin e punonjësve të administrates	NRP-2122-02-2022
21.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës	NRP-2123-02-2022
22.	Vendim autorizimi për ushtrimin e pozitës	NRP-2125-02-2022

23.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2132-02-2022
24.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2134-02-2022
25.	Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit	NRP-2136-02-2022
26.	Vendim për pranimin në marrëdhënie pune	NRP-1910-02-2022
27.	Vendim për pranimin në marrëdhënie pune	NRP-1911-02-2022
28.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2142-02-2022
29.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2143-02-2022
30.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2144-02-2022
31.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-2152-02-2022
32.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-2163-02-2022
33.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave në projektin "Përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor"	NRP-2164-02-2022
34.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2167-02-2022
35.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2168-02-2022
36.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2169-02-2022
37.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2170-02-2022
38.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2171-02-2022
39.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2172-02-2022
40.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2173-02-2022
41.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2174-02-2022
42.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2175-02-2022
43.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2176-02-2022
44.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2177-02-2022
45.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2178-02-2022
46.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2179-02-2022
47.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2180-02-2022
48.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2181-02-2022
49.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2182-02-2022
50.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2183-02-2022
51.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2184-02-2022
52.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2185-02-2022
53.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2186-02-2022
54.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2187-02-2022
55.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2189-02-2022
56.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2190-02-2022
57.	Vendim për ndihmë financiare	NRP-2191-02-2022


58.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-2197-02-2022
59.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-2198-02-2022
60.	Vendim për shpalljen e procedurës për ngritje në detyrë	NRP-2199-02-2022
61.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-2205-02-2022
62.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-2206-02-2022
63.	Vendim për caktimin e Grupit Punues për rishikimin e planit komunal lokal për mbeturina në Komunën e Rahivecit	NRP-2210-02-2022

Rahovec, maj 2022





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës: 29. 3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Furnizim me letër A4 për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-22-3784-1-3-6 & 623-22-013-1-3-6 të datës: 4.5.2022, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Krasniqi, kryesues
 - 1.2. Arta Kabashi, anëtare
 - 1.3. Liridon Gashi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për “Furnizim me letër A4 për nevojat e komunës së Rahovecit”, me Nr. prokurimi: 623-22-3784-1-3-6 & 623-22-013-1-3-6 të datës: 4.5.2022, në këtë përbërje.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No. 2024 Nr. Ifaq/Br.su/No.pg 366
Data/Datum/Date 4 / 5 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “Furnizim me rekuizita sportive për shkolla” me numër të kontratës 623-22-1399-1-2-1/C364, si në vijim:
 - 1.1 z. Qamil Sylka, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Depoist pranë Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtorja për Arsim, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ

II
RAHOVEC
ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / MUNICIPALITY OF ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAH. VILC
KRYETARI I KOMUNES E KRYETAR PRESIDENKA OPSTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 2236 Nr. i faq./Br.str./No.pg 367
Data/Datum/Date 5 / 5 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63, 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, në përputhje me Thirrjen Publike për Aplikim me Nr. Prot. 705 të datës 04.03.2022 për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e sportit nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike me Nr. Prot. 1355 të datës 20.4.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ekzekutimin e mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e sportit nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

1. Me këtë vendim lejohet ekzekutimi i mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e sportit duke u bazuar në Thirrjen publike për aplikim me Nr. Prot. 705, të datës: 4.03.2022 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të Komisionit Nr. Prot. 1355, të datës: 20.4.2022 për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike.
2. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur Thirrjen publike për aplikim për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e sportit duke iu përmbajtur dispozitave të Rregullore MF-NR- 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Pas kësaj, është caktuar komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike për aplikim me Nr. Prot. 02/1809/22 i datës 29.3.2022.

Komisioni pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve ka marrë vendim me Nr. 1355, të datës: 20.4.2022 dhe ka shpallur fitues OJQ-të të cilët kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e caktuara për të qenë përfitues të subvencioneve në fushën e sportit.

Andaj duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos i në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINETI PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No	02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No	2037
Nr. i faq./Br. str./No. pg	367
Data/Datum/Date	5 / 5 / 22

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63, 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, në përputhje me Thirrjen Publike për Aplikim me Nr. Prot. 706 të datës 04.03.2022 për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës dhe rinisë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike me Nr. Prot. 1377 të datës 21.4.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ekzekutimin e mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e kulturës dhe rinisë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

1. Me këtë vendim lejohet ekzekutimi i mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e kulturës dhe rinisë duke u bazuar në Thirrjen publike për aplikim me Nr. Prot. 706, të datës: 4.3.2022 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të komisionit Nr. Prot. 1377, të datës: 21.4.2022 për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike.
2. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur Thirrjen publike për aplikim për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e kulturës dhe rinisë duke iu përmbajtur dispozitave të Rregullore MF-NR- 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Pas kësaj, është caktuar Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të dhe individët mbi bazën e thirrjes publike për aplikim me Nr. Prot. 02/1808/22 i datës 29.3.2022.

Komisioni pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve ka marrë vendim me Nr. 1377 të datës 21.4.2022 dhe ka shpallur fitues OJQ-të të cilët kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e caktuara për të qenë përfitues të subvencioneve në fushën e kulturës dhe rinisë.

Andaj duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos i në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.






Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opštine Orahovac/Municipality of Rahovec



Kryetari i komunës/Presednik Opštine/Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kërkesës së punëtores të miratuar nga eprori i drejtpërdrejt, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. QËNDRESA DURAKU** nga Krusha e Madhe, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të caktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për marrëdhënie me publikun pranë Kabinetit të Kryetarit të komunës, i aprovohet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajve sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë nga data dt.01.05.2022 deri 01.11.2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Administratë.

A r s y e t i m

Punonjësja QËNDRESA DURAKU nga Krusha e Madhe, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të caktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për marrëdhënie me publikun pranë Kabinetit të Kryetarit të komunës, e ka njoftuar Kryetarin e komunës, se nga data 01.05.2022 do të shkojë në pushim të lehonisë për 6 muaj, sipas fletë lëshimit të spitalit të Gjakovës në nr.4286/2022.

Duke pasur parasysh se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që punëtorja ta realizoj pushimin e lehonisë .

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Nëpunësia ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- **znj. Qëndresa Duraku**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**
- **Dosja e punëtores**
- **Arkiva**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Orahovac

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 62 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/2019"), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kërkesa Nr1544 e datës 06.05.2022 e z. Haziz Krasniqi, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për lirim nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil

1. Me këtë vendim **LIROHET** nga marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil z. Haziz Krasniqi nga fsh. Pastasellë Komuna e Rahovecit, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës zyrtarë për Informim pranë zyrës së Kryetarit dhe i ndëprehet Aktemërimi 01Nr. 1699 i datës 19.05.2016.
2. **OBLIGOHET** Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të larpërmendurin në pikën 1 të këtij vendimi ta largoj nga lista e pagave.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Njësia e Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me datë 06.05.2022 z. Haziz Krasniqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës zyrtar për informim pranë zyrës së Kryetarit të Komunës e Rahovecit, me anë të kërkesës ka kërkuar të lirohet nga detyra në pozitën e zyrtarit për informim,

Andaj, duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i larpërmenduri ka njoftuar me shkrim për dorëheqje nga Shërbimi Civil.

Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 62 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, z. Haziz Krasnisi, lirohet nga detyra e zyrtarit për informim në Komunën e Rahovecit.

Pas administrimit të të gjitha provave dhe fakteve si dhe duke u bazuar në kërkesën mbi lirimin nga detyra e zyrtarit për informim, respektivisht nga shërbimi civil, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që z. Haziz Krasniqi nga Fshati Pastasellë, Komuna e Rahovecit të lirohet nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil si dhe njëkohësisht i ndëprehet Aktemërimi 01Nr. 1699 i datës 19.05.2016.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Me vendim të njoftohen:

- Z. Haziz Krasniqi nga fshati Pastasellë,
- Njësia e Personelit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2278 Nr. i faq./Br.str./No.pg 371

Data/Datum/Date 10/5/22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmit

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në tokën pyjore sipas kërkesës me Nr. Prot. 1384 të datës 21.04.2022, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Kryeziu, kryesues
 - 1.2. Hasan Vuçitërna, anëtar
 - 1.3. Egzon Thaqi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatoj dhe të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në tokën pyjore sipas kërkesës me Nr. Prot. 1384 të datës 21.04.2022.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Komisioni do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZHR, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Orahovac
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIDENKUT OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2082 Nr. i faq./Br.str./No.pg 372
Data/Datum/Date 10 / 5 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në Rahovec me Nr. **Protokolit 1267** të dt. **13.04.2022** për ndihmë financiare prej **950.00€** (nëntëqind e pesëdhjetë) për mbulimin e shpenzimeve për participim në blerjen e ilaçeve dhe participim në rehabilitimin e pensionistëve në qendrat rehabilituese.
2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë financiare të kategorisë së pensionistëve të Komunës së Rahovecit pasi që shumica e kësaj kategorie janë pensionista me nevoja sociale, është e arsyeshme që kjo kategori e shoqërisë sonë të përkrahet në mënyra të ndryshme.

Andaj, me qëllim të përkrahjes së kësaj kategorie të shoqërisë, është e domosdoshme ndihma financiare për participim në blerjen e barnave, participim në rehabilitimin e tyre në qendrat rehabilituese si dhe në projektet e ndryshme të kësaj organizate, që kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të pensionistëve të Komunës së Rahovecit.

Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi


Vendimi u dërgohet :

- OK të PIP-së,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.

Smail Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** Kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Rahovec me Nr. Prot. 1561 të dt. 10.05.2022.
2. OVL - UÇK-së, i ndahen 60 (gjashtëdhjetë) litra naftë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të shoqatave të dala nga lufta për muajin maj, të cilat janë në plan programin e OVL – UÇK-së.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Administratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- OVL – UÇK-së në Rahovec,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / KABINET OF THE MUNICIPAL MAYOR

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetari)

Nr./Br./No 2085 Nr. i faq./Br.str./No. p. 372

Data/Datum/Date 10 / 5 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 per Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së z. Berat Duraku të datës 10.05.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Me këtë vendim z. Berat Duraku, Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit në Komunën e Rahovecit i lejohet udhëtimi zyrtar.
2. z. Berat Duraku do të marrë pjesë në panairin e produkteve bujqësore dhe serrave, i cili do të mbahet në Kumluca të Republikës së Turqisë që do të mbahet nga data 12 maj 2022 deri me datë 15 maj 2022.
3. I lartpërmenduri ka të drejtë të udhëtoj zyrtarisht, të zgjedh mënyrën e udhëtimit varësisht nga organizimi dhe ka të drejtë që të kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:


- Z. Berat Duraku,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Arkivi.

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit të Nën-granteve

1. **Caktohet komisioni vlerësues i Nën-granteve, në këtë përbërje:**
 - 1.1. Afrim Dina, kryesues
 - 1.2. Shahinderre Kollari, anëtar
 - 1.3. Sedat Vuqitërna, anëtar
 - 1.4. Albulena Gashi, anëtar
 - 1.5. Ali Lushi, anëtar
 - 1.6. Labinot Berisha, anëtar
 - 1.7. Vjollca Gurgule, anëtar
 - 1.8. Edmond Gashi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e Nëngranteve për projektin "Komuna për të Rinjtë" në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Pas përfundimit të punëve obligohet komisioni që të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 16 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e z. Albion Krasniqi nga Rahoveci, me Nr. Prot. 1562 të datës 10.05.2022 për kryerjen e punës praktike në Sektorin për punë të Kuvendit dhe Komiteteve pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. z. Albion Krasniqi, i diplomuar në Fakultetin Juridik pranë Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë, themelon marrëdhënie pune – **PRAKTIK PA PAGESË** duke filluar prej datës 11.05.2022 deri me datë 11.08.2022.
3. Obligohet i lartpërmenduri që në përpikëri të respektoj Kodin Etik të punës.
4. Obligohet Drejtoria për Administratë që praktikantit ti sigurohen mjetet e punës si: Tavolina pune, kompjuter, material administrativ, etj.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

z. Albion Krasniqi nga Rahoveci me datë 10.05.2022 ka paraqitur kërkesë pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës për kryerjen e punës praktike në Drejtorinë për Administratë në periudhën prej 3 (tre) muaj, respektivisht nga data 11.05.2022 deri me datë 11.08.2022.

Duke marrë parasysh nevojën e ngritjes profesionale të të lartpërmendurit, pasi që i njëjti është duke vazhduar studimet në Master, në drejtimin qeverisja lokale dhe shoqëria demokratike pranë Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, është e domosdoshme krijimi i kushteve për kryerjen e punës praktike.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- z. Albion Krasniqi,
- Drejtorisë për Administratë, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



Kryetari i Komunës / Председник Општине/Municipal Mayor
NETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINETI PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2106 Nr. i faq./Br.str./No.pg 374
Data/Datum/Date 12/5/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kërkesës së punëtores të miratuar nga eprori i drejtpërdrejt, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit të lehonisë

1. **Znj. NJOMËZA FAZLIU** nga Celina, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të caktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për zotimin e mjeteve pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, i aprovet pushimi i lehonisë në kohëzgjatje prej 12 muajve sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë do të paguhet nga punëdhënësi me kompensim 70% të pagës bazë nga data dt.01.11.2021 deri 30.04.2022.
3. Ndërsa, 3 (tre) muajt në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data 01.05.2022 deri 31.07.2022.
4. Ndërsa, 3 muajt e tjerë do të jenë pa pagesë .
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

A r s y e t i m

Punonjësjë NJOMËZA FAZLIU nga Celina, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të caktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për zotimin e mjeteve pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, e ka njoftuar drejtorin se nga data 01.11.2021 deri 30.04.2022 do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletë lëshimit të spitalit të Prizrenit nr.1258/2021.

Punëtorja nga data 01.05.2022 deri me dt.31.07.2022 shkon në pushim të lehonisë për 3 muaj me pagesë 50% të pagës mesatare në Kosovë.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Nëpunësia ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- **Znj. Njomëza Fazliu**
- **Drejtorja për Buxhet dhe Financa**
- **Ministria e Punës dhe MS**
- **dosja e punëtores**
- **arkiva**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komunë e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec / Општина Оrahovac / Municipality RAHOVEC

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2411 Nr. i faq/Br.str./No.pg 374

Data/Datum/Date 13.5.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Asgjësimi i barnave me afat të skaduar" me numër të kontratës 623-22-2161-2-2-1/C366, si në vijim:
 - 1.1 z. Elbunit Kryeziu, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës U.D. i Drejtorit të QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 znjsh. Saranda Sallteku, Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Menaxheri i projektit,
- Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,
- Sektori i Prokurimit,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivi.

Smail Latifi

Kryetari i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) neneve 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë :

V E N D I M

Për formimin e komisionit për regjistrimin e sendeve të luajtshme nga objekti i banimit që gjendet në ngastren kadastrale me P-71513005-01054-0 në vendin e quajtur Selo – Selo, Zona kadastrale Krusha e Madhe, Komuna e Rahovecit

1. Kaktohet komisioni për regjistrimin - evidentimin e sendeve të luajtshme që gjendet në hapsirat e objektit të banimit në ngastren kadastrale me P-71513005-01054-0 në vendin e quajtur Selo – Selo, Zona kadastrale Krusha e Madhe që gjendet në Komunën e Rahovecit, në përbërje :
 - 1.1 Asllan Mazreku, Kryesues
 - 1.2 Nazmi Krasniqi, anëtar
 - 1.3 Vahdet Kadiri, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të dalë në vend, të bëjë regjistrimin - evidentimin e sendeve të luajtshme që gjenden në hapsirat e objektit të banimit në ngastren kadastrale me P-71513005-01054-0 në vendin e quajtur Selo – Selo, Zona kadastrale Krusha e Madhe që gjendet në Komunën e Rahovecit.
3. Obligohet Komisioni të hartojë një rexhister të detajuar për sendet të cilat gjenden në hapsirat e objektit të banimit në ngastren kadastrale me P-71513005-01054-0 në vendin e quajtur Selo – Selo, Zona kadastrale Krusha e Madhe që gjendet në Komunën e Rahovecit.
4. Obligohet Komisioni që pas përfundimit të punës të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit

U dërgohet :

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe
- Arkivi

	REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 2112 Nr. i faq./Br.str./No pg 374		
Data/Datum/Date 13 / 5 / 22		
RAHOVEC / ORAHOVAC		





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PRESIDENKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2113 Nr. i faq./Br.str./No.pg 375

Data/Datum/Date 13 / 5 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] me Nr. Protokolit 1504, të dt. 04.05.2022 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

[redacted] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërbalueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.

Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- [redacted]
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br.No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2117 Nr. i faq./Br.str./No.pg 375

Data/Datum/Date 16 / 5 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës në Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike

1. znj. Blerta Gashi, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për Lektorim, pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës, **CAKTOHET**:

1.1. Zyrtare përgjegjëse për qasje në dokumente publike në Komunën e Rahovecit.

2. Obligohet zyrtarja për qasje në dokumente publike që të garantoj të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje në dokumente publike pas kërkesës, në dokumentet hartuara, mbajtura apo pranuar nga Kuvendi, Kryetari dhe drejtoritë në Komunën e Rahovecit.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtares për qasje në dokumente publike janë të caktuara në Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zyrtarja e caktuar për qasje në dokumente publike.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01/22/18 i datës 16.01.2018.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- znj. Blerta Gashi,
- Agjencia për Informim dhe Privatësi,
- Drejtorëve të drejtorive, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No. 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No. 2118 Nr. i faq./Br.str./No. pg. 375

Data/Datum/Date 16 / 5 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës në Rahovec, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtares përgjegjëse për menaxhimin e Platformës së konsultimeve publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Rahovecit

1. znj. Blerta Gashi, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për Lektorim, pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës, **CAKTOHET:**
 - 1.1. Zyrtare përgjegjëse për menaxhimin e platformës së konsultimeve publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Rahovecit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtares përgjegjëse për menaxhimin me platformën e konsultimeve publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Rahovecit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset zyrtarja e caktuar për menaxhimin e platformës së konsultimeve publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Rahovecit.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/241/20, i datës: 27.01.2020.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- znj. Blerta Gashi,
- Zyrës së Personelit,
- Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për qasje në dokumente publike

Miratohet kërkesa me Nr. Prot. 1710, e datës: 17 maj 2022 për qasje në dokumente publike nga **Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)** dhe i lejohet qasja në:

- Raporti i muajit dhjetor 2021 për pagat e asambleistëve komunal
- Buxheti i DKA për secilin institucion arsimor për vitin 2021

1. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

- Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesë me Nr. Prot, e datës: 17 maj 2022, nga **Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)** për qasje në dokumente publike, përkatësisht qasje të plotë te **Raporti i muajit dhjetor 2021 për pagat e asambleistëve komunal dhe Buxheti i DKA për secilin institucion arsimor për vitin 2021.**

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë **ELEKTRONIKE**.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dergohet:

- **Blerta Gashi, Zyrtares për shqyrtimin fillestar të QDP,**
- **Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe**
- **Arkivit.**

 
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRIDREDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No <u>2124</u> Nr. ifaq/Br.su/No.pq <u>375</u>
Data/Datum/Date <u>17/5/2022</u>
RAHOVEC / ORAHOVAC



Smajl Latifi

Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRIDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2122 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 375
Data/Datum/Date 17.15.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim punonjësit e administratës së Komunës së Rahovecit caktohen që të mbajnë trajnimet për aftësimin e tyre në pozitat si në vijim:
 - 1.1. Egzon Thaçi - për pozitën Zyrtar shpenzues;
 - 1.2. Bekim Krasniqi - për pozitën Zyrtar zotues;
 - 1.3. Pajtim Haxhijaha - për pozitën Zyrtar për Cash plan (rrjedhja e parasë)
 - 1.4. Liridon Gashi – për pozitën Zyrtar i të hyrave; dhe
 - 1.5. Lulzim Krasniqi - për pozitën Zyrtar i nënalokimeve në arsim.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të lartpërmendurit, Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Të lartpërmendurve,
- Drejtorisë për Administratë,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PRESIDITKA OPSTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2123 Nr. i faq./Br.str/No.pg 376
Data/Datum/Date 17.5.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me laptop për Kuvendin Komunal" me numër të kontratës 623-22-1852-1-2-1/C365 si në vijim:
 - 1.1 z. Dritan Sokoli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për Teknologji Informative, pranë Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 z. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Menaxheri i projektit,**
- **Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,**
- **Spektori i Prokurimit,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

